



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.395/10 prot

Datë 20.03.2025

V E N D I M

Nr. 388/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.03.2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “Blerje Shërbim të Printimit”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “InfoSoft Office” SHPK & “BNT Electronics” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tiranë, me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë.

Ankimues:

BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK përkatësisht me NUIS L22119010H & L01606034A dhe adresë: Njësia Administrative Kashar, Rruga “Ismail Qemali”, ND.40, H. 28, 1050, Yzberisht, Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

BOE “InfoSoft Office” SHPK & “BNT Electronics” SHPK, përkatësisht me NUIS J62426002Q & J61817047D dhe adresë: Kashar, Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.12.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “*Blerje Shërbim të Printimit*”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 23.01.2025, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK	28.675.000 lekë, skualifikuar
BOE “Infosoft Office” SHPK & “BNT Electronics” SHPK	28.705.000 lekë, kualifikuar

BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij nga ana e KVO-së.

II.3. Në datën 31.01.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK përsëri është njoftuar për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, konkretisht si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe dokumenteve të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik nga ku rezultoi si vijon:

I. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.2.1 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar pjesë e Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

“2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: 29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh.Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”

Operatori Ekonomik “PC Store” sh.p.k anëtar i BOE në përmbushje të kriterit 2.2.1 ka paraqitur dokumentacionin “Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit)” të lëshuar nga Drejtoria Rajonale

e Tatimeve Tiranë, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, në të cilën faktohet situata financiare vetëm për vitet 2022, 2023, por për vitin 2024 nuk faktohet situata financiare.

Thënë kjo dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e kriterit 2.2.1 jo vetëm që nuk vërteton xhirot vjetore respektivisht sipas viteve financiare të kërkuara në kërkesat e kriterit të sipërcituar (2021, 2022 dhe 2023) por gjithashtu nuk është i plotë në vetvete, pasi nuk përmban situatën financiare për vitin 2024.

Për sa më sipër cituar, KVO gjykon se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k nuk ka përmbushur pikën 2.2.1 sipas kërkesave të këtij kriteri.

II. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik pjesë e Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt të kësaj kontrate, duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e inxhinierëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratë pune e vlefshme, kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Kriteri 2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Në zbatim të kriterit të sipërcituar, Operatorët Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k kanë deklaruar në dokumentet e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentin “Kontratë Bashkëpunimi” konkretisht:

Pc Store: 3 (tre) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha). A.A Diplomuar Informatike Ekonomike Nr.001288F A.B Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr.000191 E.M Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr.000188

Rikon-AL: Të angazhojë 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik për ekzekutimin e kontrarës.

Bazuar në dokumentin “Kontratë Bashkëpunimi”, në të cilën Operatorët BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, citojnë se:

- PC STORE shpk do të ketë pjesëmarrje 20% në këtë procedurë.

- RIKON-AL shpk do të ketë pjesëmarrje 80% në këtë procedurë

Deklarimi në përmbushje të kriterit 2.3.3 nuk përkon me inxhinierët e punësuar në fushat e kërkuara pasi PC Store sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 2, ndërsa Rikon-AL sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 inxhinier. Thënë kjo Deklarimi i Rikon-AL nuk përmbush kërkesat e këtij kriteri referuar pjesëmarrjes prej 80% në këtë procedurë prokurimi.

Si rrjedhojë KVO gjykon se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, nuk përmbush kërkesat e kriterit 2.3.3 dhe nuk konsiderohet i përmbushur.

III. Autoriteti Kontraktor në kriterin 2.3.7 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

“2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar”.

Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k në përmbushje të kriterit 2.3.7 ka paraqitur dokumentacionin “Deklaratë” të datës 13.01.2025, në të cilën deklaron se:

“Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Në rast se renditemi si oferta më e mirë, në zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me dokumentacionin e ofertes do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve.”

Si dhe në pikën B: “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohej)” të dokumentit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit shtojca 10 e dokumenteve standarte të tenderit Operatori Ekonomik ka deklaruar “

“Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Në rast se renditemi si oferta më e mirë, në zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me dokumentacionin e ofertes do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve.”

Referuar sa më sipër KVO gjykon se bazuar në kërkesat e kriterit 2.3.7 Autoriteti Kontraktor thekson qartësisht se “Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve, dhe nuk citohen se plotësimi i këtij kriteri përmbushet/vërtetohet nëpërmjet një deklarate të nënshkruar nga Operatori Ekonomik.

Gjithashtu theksojmë se ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur në këtë moment procedural, me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DST, sikurse nuk është kërkuar në kërkesat e këtij kriteri.

Si rrjedhojë KVO gjykon se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion vërtetues sipas kërkesave të kriterit 2.3.7 dhe nuk konsiderohet i përmbushur.

Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin 2.2.1, të Kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe kriteret 2.3.3 dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik.

Në përfundim, KVO konkludon njëzëri se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, s’kualifikohet nga procedura e prokurimit me objekt “Blerje Shërbim të Printimit”.

II.4. Në datën 10.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5039, protokolluar me nr.395/2025 prot, datë 11.02.2025, i BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “Blerje Shërbim të Printimit”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe pretendohet kualifikimi i padrejtë i BOE “InfoSoft Office” SHPK & “BNT Electronics” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...] Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

- *Në lidhje me legjitimitetin e ankimit*

Legjitimiteti aktiv (legittimatio activa) i palës në një proces gjyqësor/administrativ nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim.

Interesi legjitim lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës/organeve administrative të shqyrtimit/apelimit njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose cënuar prej dikujt tjetër.

- *Në lidhje me legjitimitetin e ankuesit*

RIKON-AL është caktuar lider i BOE përmes kontratës së bashkëpunimit të paraqitur në tender, me tagrat e përfaqësimit për të përfaqësuar BOE RIKON-AL dhe PC STORE, në të gjitha procedurat e tenderit, përfshirë edhe ankimin administrativ

- *Në lidhje me afatin e ankimit, legjitimitetin ratione temporis*

Në mbështetje të nenit 110 “Afatet për ankim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, e drejta për ankim lind nga operatrët e interesuar, në rastin konkret, si vijon:

2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen Brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Njoftimi i publikimit të procedurës së prokurimit publik është publikuar në rubrikën e mesazheve në SPE në datën 31.01.2025 prandaj RIKON-AL legjitimohet ratione temporis, sepse e ka paraqitur ankesën brenda afatit të përcaktuar 10 ditor për ankesat, sipas ligjit, njëkohësisht në AK dhe KPP.

- *Mbi themelin e ankimit*

Pika 1:

Në lidhje me pikën e parë të skualifikimit të RIKON-AL, e cila është:

“Autoriteti Kontraktor në pikën 2.2.1 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar pjesë e Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumentave Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

“2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: 29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh.Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor.”

Operatori Ekonomik “PC Store” sh.p.k anëtar i BOE në përmbushje të kriterit 2.2.1 ka paraqitur dokumentacionin “Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit)” të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, në të cilën faktohet situata financiare vetëm për vitet 2022, 2023, por për vitin 2024 nuk faktohet situatë financiare.

Thënë kjo dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e kriterit 2.2.1 jo vetëm që nuk vërteton xhirot vjetore respektivisht sipas viteve financiare të kërkuara në kërkesat e kriterit të sipërcituar (2021, 2022 dhe 2023) por gjithashtu nuk është i plotë në vetëvete, pasi nuk përmban situatën financiare për vitin 2024.

Për sa më sipër cituar, KVO gjykon se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k nuk ka përmbushur pikën 2.2.1 sipas kërkesave të këtij kriteri.”

Ankesë 1:

Ky vlerësim i KVO është tërësisht i gabuar dhe aspak në përputhje me parashikimet e LPP dhe frymën e vendimeve të KPP.

Risjellim në vëmendje që AK, në kriterin përkatës ka kërkuar që:

2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: 29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor AK, së pari, kryen një vlerësim të gabuar, i cili bie në kundërshtim të hapur edhe me vetë kriterin financiar të kërkuar në DST.

AK njëherë përcakton se “vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: 29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor” dhe nga ana tjetër po i njëjti AK në arsyen e skualifikimit vendos skualifikimin e BOE, sepse nuk përmbush kriterin e xhiros vjetore, meqë njëri vërtetim i xhiros ka

të paraqitur vetëm 2 vite dhe jo 3 vite, pavarësisht që sasia e xhiros së paraqitur nga secili antar i BOE e përmbush dhe tejkalon kërkesën për xhiron vjetore të vetë AK.

Konkretisht: AK ka kërkuar që për të paktën 1 vit, OE që të kualifikohet duhet të ketë realizuar një xhiro vjetore minimalisht 29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

BOE RIKON & PC STORE, ka paraqitur vërtetim xhiro në sasinë dhe në vitet si vijon:

1. Vërtetimi i xhiros i gjeneruar nga e-albania i datës 11.01.2025 paraqitur nga RIKONAL, si vijon:

Viti 2023 me xhiro vjetore 137,704, 363 lek pa TVSH

Viti 2022 me xhiro vjetore 122,900, 064 lek pa TVSH

Viti 2021 me xhiro vjetore 78,311,078 lek pa TVSH

2. Vërtetimi i xhiros i gjeneruar nga e-albania i datës 09.01.2025 i paraqitur nga PC STORE, si vijon:

Viti 2023 me xhiro vjetore 807,396,482 lek pa TVSH

Viti 2022 me xhiro vjetore 785,511,707 lek pa TVSH

Ndërkohë, xhiro e kërkuar nga AK është minimalisht që në njërin vit të ketë realizuar 29,162,200 lek pa TVSH dhe “Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor”.

Sic edhe shihet qartë, xhiro i secilit OE, pjesë e BOE, edhe në vitin më të keq financiar ka realizuar xhiro në 1 vit, më shumë se dyfishi i xhiros së kërkuar nga AK Bashkia Tiranë.

Kapaciteti i xhiros vjetore dhe përmbushja e tij, tashmë është një praktikë e njohur e KPP dhe për ilustrim, mund ti referoheni edhe vendimit të KPP Nr.1220/2023 datë 23.11.2023, me palët OE QuantX IT Solutions kundër AK Bashkia Fier.

Për sa më sipër, skualifikimi i BOE me pretendimin që nuk plotëson kriterin e xhiros vjetore, është një skualifikim i pabazë, i pambështetur në ligj dhe në prova dhe duhet të hidhet poshtë dhe BOE RIKON-AL & PC STORE, duhet të kualifikohet në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

KËRKESË 1:

Kërkojmë: “Rrëzimin e arsyes së skualifikimit, pranimin e ankesës sonë dhe kualifikimin e ofertës së BOE RIKON-AL&PC STORE në procedurën e prokurimit objekt të kësaj ankese.

Pika 2:

Në lidhje me pikën e dytë të vendimit të KVO për skualifikimin e ofertës së RIKON-AL, e cila është si vijon:

“Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik pjesë e Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumentave Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt të kësaj kontrate, duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- *Eksperienca e punës dhe profilet e inxhinierëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratë pune e vlefshme, kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.*

Kriteri 2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në zbatim të kriterit të sipërcituar, Operatorët Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k kanë deklaruar në dokumentet e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentin “Kontratë Bashkëpunimi” konkretisht:

Pc Store: 3 (tre) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha). A.A Diplomuar Informatike Ekonomike Nr.001288F A.B Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr.000191 E.M Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr.000188

Rikon-AL: Të angazhojë 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik për ekzekutimin e kontrarës.

Bazuar në dokumentin “Kontratë Bashkëpunimi”, në të cilën Operatorët BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, citojnë se:

PC STORE shpk do të ketë pjesëmarrje 20% në këtë procedurë.

- RIKON-AL shpk do të ketë pjesëmarrje 80% në këtë procedurë

Deklarimi në përmbushje të kriterit 2.3.3 nuk përkon me inxhinierët e punësuar në fushat e kërkuara pasi PC Store sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 2, ndërsa Rikon-AL sh.p.p duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 inxhinier. Thënë kjo Deklarimi i Rikon-AL nuk përmbush kërkesat e këtij kriteri referuar pjesëmarrjes prej 80% në këtë procedurë prokurimi.

Gjykojmë se është një arsye e pabazuar në ligj në fakte dhe prandaj po paraqesim argumentat në vijim.

Ankesë 2:

Theksojmë se kjo arsye skualifikimi i paraqitur nga KVO në AK, është një arsye skualifikimi e pambështetur në ligj dhe për më tepër as në logjikën e thjeshtë të procedurave të prokurimit publik. OE RIKON-AL, duke qenë se nuk dispononte në listëpagesë të gjithë inxhinierët dhe makineritë/pajisjet e kërkuar nga AK, gjykoi të bashkonte kapacitetin teknik me OE PC STORE, për të ofertuar si bashkim operatorësh ekonomike në procedurën e tenderit objekt ankimi.

Duke qenë se LPP, detyron që BOE të krijohet si e tillë përmes hartimit të një kontratë ndërmjet palëve pjesëmarrëse, BOE RIKON-AL dhe PC STORE, kanë nënshkruar dhe paraqitur në SPE, kontratën e bashkëpunimit të datës 11.01.2025, ku janë përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes dhe të drejtat dhe detyrimet konkrete të palëve kontraktuese.

Konkretisht PC STORE, me pjesëmarrje 20% në BOE, merr përsipër si vijon:

Shoqeria PC STORE shpk e cila është e certifikuar sipas sipas standarteve ISO, ISO 9001:2015, ISO 27001:2, ISO 20001, cila merr përsipër që në përputhje me detyrat dhe përqindjen e pjesëmarrjes respektive të përcaktuar në këtë marrëveshje, merr përsipër të realizojë, si vijon:

1. Të angazhojë 3 (tre) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha).
2. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar si project Manager ose ekuivalent për të siguruar implementimin e suksesshem të shërbimit të kërkuar përgjate kohëzgjatjes së kontratës.
3. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
4. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Sëitching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes softëare dhe të pajisjeve të kërkuara
5. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit softëare në infrastrukturën përkatëse dhe AD.
6. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave.
7. Të vendosë në dispozicion 3 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhene shërbimin në kohë në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë.
8. Të furnizojë 20% të pajisjeve të printimit të kërkuara.
9. Të angazojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të mbështetur partnerin RIKON-AL në rast se gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të kontratës.

Dhe lider i BOE, OE RIKON-AL, merr përsipër si vijon:

Shoqeria RIKON-AL shpk, e cila është e certifikuar sipas sipas standarteve ISO, ISO 9001:2015, ISO 270001: ISO 200001, cila merr përsipër që në perputhje me detyrat dhe përqindjen e pjesëmarrjes respektive të percaktuar në kete marrëveshje, merr përsipër të realizojë, si vijon:

1. Të angazhojë 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik për ekzekutimin e kontrarës.
2. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
3. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
4. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
5. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
6. Të furnizojë 80% të pajisjeve të kërkuara.
7. Të angazhojë 4 automjete transporti për realizimin e kontratës.
8. Të angazojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të garantuar realizimin e kontratës nëse gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të saj.

Pra, kjo kontratë BOE është një bashkim i mirëfilltë për përmbushjen së bashku të kontratës për sa i përket kapacitetit teknik. Kapaciteti Teknik, si rregull përmban:

1. Burimet njerëzore të kualifikuara

2. Automjete dhe kapacitete logjistike

3. Makineri dhe pajisje

Dhe për të përmbushur kapacitetin teknik, është përcaktuar që në total, RIKON-AL të përmbushë 80 % të volumit të kontratës, përfshirë vendosjen e pajisjeve të printimit/fotokopjimit/skanimit në masën 80 % të tyre, (nr i këtyrë pajisjeve është pjesa më e rëndësishme e zbatimit të kontratës publike), angazhimin e inxhinierëve/specialistëve/technikëve të kualifikuar dhe automjeteve për transportin e pajisjeve në adresat e përcaktuara nga AK.

Gjithashtu edhe PC STORE, merr përsipër të vendosë 20% të totalit të pajisjeve të printimit/fotokopjimit/skanimit, si edhe angazhimin e inxhinierëve/specialistëve/technikëve të kualifikuar dhe automjeteve për transportin e pajisjeve në adresat e përcaktuara nga AK.

Ndarja 80% për RIKON-AL dhe 20% për PC STORE, është një marrëdhënie mes dy palëve konkrete dhe nuk është shqetësimi i KVO, pretendimi i pabazuar se PC STORE ka vënë 1 inxhinier më pak dhe RIKON 1 inxhinier më shumë apo sesa punonjës duhet të punësojë në cilësinë e inxhinierit RIKON-AL dhe PC STORE.

Për më tepër, PC STORE në cdo rast, sipas dispozitave të kontratës së bashkëpunimit merr përsipër të angazhojë burime dhe asete shtesë, për të ndihmuar partnerin RIKON-AL për zbatimin e kënaqshëm të kontratës nëse një sfidë e tillë shtrohet për zgjidhjen nga Ak, apo rrethanat e realizimit të kontratës.

Duke qenë se vendosja e pajisjeve në punë në ambjentet e AK, përbën sfidën më të madhe kontraktuale në kontratën publike, ndarja 80%/20% mes antarëve të BOE i përgjigjet më së miri detyrimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit të paraqitur në SPE.

Nuk është as e drejtë e as detyrë e KVO në AK, të vlerësojë së si duhet të jenë marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet antarëve të një BOE ofertues në procedurën e prokurimit.

Detyra që shtrihet ligji për prokurimin publik për zbatim për KVO është vlerësimi dhe garantimi se OFERTUESI disponon mjetet e duhura financiare, eksperiencën e duhur, burimet njerëzore të kualifikuara dhe kapacitetet logjistike dhe operacionale për të marrë përsipër realizimin e kësaj kontrate publike dhe asgjë më shumë se përtej kësaj detyre. Cdo tejkalim përbën një akt administrativ të nxjerrë në mungesë të kompetencës.

Prandaj për sa më sipër, vendimi i KVO për skualifikimin e BOE me pretendimin që “Deklarimi në përmbushje të kriterit 2.3.3 nuk përkon me inxhinierët e punësuar në fushat e kërkuara pasi PC Store sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 ndërsa Rikon-AL sh.p.p duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 inxhinier. Thënë kjo Deklarimi i Rikon-Al nuk përmbush kërkesat e këtij kriteri referuar pjesëmarrjes prej 80% në këtë procedurë prokurimi.” është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet të hidhet poshtë.

KËRKESË 2:

Kërkojmë: “Rrëzimin e arsyes së skualifikimit, pranimin e ankesës sonë dhe kualifikimin e ofertës së RIKON-AL në procedurën e prokurimit objekt të kësaj ankese.

Pika 3:

Arsyeja e tretë e skualifikimit të RIKON-AL është pretendimi i KVO për kapacitetin teknik, si vijon:

“Autoriteti Kontraktor në kriterin 2.3.7 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

“2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.. ”

Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k në përmbushje të kriterit 2.3.7 ka paraqitur dokumentacionin “Deklaratë” të datës 13.01.2025, në të cilën deklaroi se:

“Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit Brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Në rast se renditemi si oferta me e mirë, ne zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me dokumentacionin e ofertes do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve.”

Si dhe në pikën B: “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të dokumentit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit shtojca 10 e dokumenteve standarte të tenderit Operatori Ekonomik ka deklaruar “Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Në rast se renditemi si oferta më e mirë, në zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me dokumentacionin e ofertes do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve.”

Referuar sa më sipër KVO gjykon se bazuar në kërkesat e kriterit 2.3.7 Autoriteti Kontraktor thekson qartësisht se “Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve, dhe nuk citohen se plotësimi i këtij kriteri përmbushet/vërtetohet nëpërmjet një deklarate të nënshkruar nga Operatori Ekonomik.

Gjithashtu theksojmë se ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur në këtë moment procedural, me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DST, sikurse nuk është kërkuar në kërkesat e këtij kriteri.

Si rrjedhojë KVO gjykon se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion vërtetues sipas kërkesave të kriterit 2.3.7 dhe nuk konsiderohet i përmbushur. Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin 2.2.1, të Kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe kriteret 2.3.3 dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik.”

Ankesa 3:

Në këtë arsye skualifikimi, KVO në AK ka demonstruar edhe njëherë që nuk e njeh legjislacionin e prokurimit publik, pasi ka paraqitur një arsyetim aspak të bazuar për të kryer skualifikimin e ofertës së BOE RIKON-AL dhe PC STORE.

Risjellim në vëmendje që kërkesa e AK është:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit.

Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi

Për të përmbushur kriterin për disponimin e pajisjeve/makinerive/automjeteve, legjislatori ka parashikuar që duhet të plotësohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit deklarimi për disponimin e pajisjeve/makinerive/automjeteve.

Konkretisht, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, përmban rubrikën e tillë ku mund të deklarohet pasja e pajisjeve të tilla, si vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i> <i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i>	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Aktualisht – 17 punonjës <u>Profili i punonjësve</u> Administrator, Drejtor Shitjesh, Ekonomist, Inxhinier Elektronik, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Mekatronik, Teknik elektronik, Teknik fotokopjesh, Shofer. <u>Makineri e mjete</u> Po [x] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: Automjetete qe regjistrohen ne regjistra publike (DPSHTRR): Pajisje printimi/fotokopjimi/skanimi: 1. Deklarojmë se disponojme gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Ne rast se renditemi si oferta me e mire, ne zbatim te nenit 26 te VKM Nr.285 date
	19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashke me dokumentacionin e ofertes do te paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të paisjeve.
BOE RIKON-AL & PC STORE Agon Makolli Firma Vula Data e dorëzimit të deklaratës 13.01.2025	

Pra, duke qenë se legjislatori ka përcaktuar se disponimi i makinerive/pajisjeve do të deklarohet, paraprakisht, duke ia transferuar barrën e provës dhe deklarimit vetë Operatorit Ekonomik.

Në momentin që OE është renditur i pari, AK në bazë të ligjit e thërret për të dorëzuar dokumentacionin fizik të ngarkuar në SPE si EDHE DOKUMENTAT PËR TË VËRTETUAR DEKLARIMET NË FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT, pra edhe dokumentat /faturat/deklaratat e zhdoganimit që vërtetojnë disponimin apo posedimin e pajisjeve të printimit/skanimit/fotokopjimit.

Konkretisht, AK Bashkia Tiranë, duhet që në momentin e shpalljes së klasifikimit, të kishte thirrur BOE RIKON dhe PC STORE, për të dorëzuar dokumentacionin e tenderit dhe atë të përmendur në formular vetëdeklarimi, pasi vetëm në këtë mënyrë respektohen dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Për më tepër AK, e ka patur momentin juridik për të kërkuar sqarime nga BOE apo për të verifikuar gjendjen e pajisjeve në maganzinat e antarëve të BOE, moment juridik të cilin nuk e ka shfrytëzuar me qëllim, sepse ka dashur të kryejë një akt skualifikimi të qëllimshëm nga BOE. Prandaj, për sa më sipër, arsyen e skualifikimit të dhënë nga KVO e AK, e konsiderojmë tërësisht të pambështetur në ligj dhe si e tillë, duhet të hidhet poshtë.

KËRKESË 3:

Kërkojmë: “Rrëzimin e arsyes së skualifikimit, pranimin e ankesës sonë dhe kualifikimin e ofertës së RIKON-AL në procedurën e prokurimit objekt të kësaj ankese.

Pika 4:

Ndërsa në vijim, paraqesim dyshimet tona që BOE i kualifikuar Infosoft Office, BNT Electronics, nuk i plotëson kriteret e kërkuara në DST. Konkretisht, dyshojmë që: BOE Infosoft Office & BNT nuk plotëson:

1. BOE Infosoft Office & BNT Electronics nuk plotëson piken:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për rajonin e Shqipërisë për të gjitha pajisjet dhe komponentin softëare të ofertuara, për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi /Distributori për komponentin Softëare për menaxhimin, monitorimin e pajisjeve për pajisjet Toshiba dhe Xerox/Lexmark ,është paraqitur, vetëm për PAJISJET Kyocera , Softëare MyQ + KFS

2. BOE Infosoft Office & BNT Electronics nuk plotëson piken:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për rajonin e Shqipërisë për të gjitha pajisjet dhe komponentin softëare të ofertuara, për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të

përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi /Distributori per Pajisjen, A4 Printer te brandit Lexmark. Dokumenti i paraqitur nga perfaqesuesi i BOE, Infosoftware Office, nuk provon lidhjen e Prodhuarit Lexmark me Distributorin. Dokumenti i paraqitur nuk shprehet se Infolex S.A. eshte Distributor i autorizuar për Shqipërinë, por nënvizohet se Infolex S.A. është shites i jo me shumicë për Shqipërinë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.

3. BOE Infosoftware Office &BNT Electronics nuk plotëson pikën:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet që të paraqesë ofertën teknike ku: a) Të përcaktohen marka dhe modeli për pajisjet dhe softëare që propozon/ofertën. b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë gjithashtu, katalogë ose broshurë për mallin dhe softëare që propozon. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produktit të propozuar. Në katalog duhet të markohet me ngjyrë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara për këto pajisje Kataloget e paraqitur per Softëare për menaxhimin, monitorimin e pajisjeve Kyocera MyQ + KFS nuk plotesojne specifikimin: Menaxhimin dhe konfigurimin e pajisjeve në mënyrë të centralizuar. Per pajisjet Xerox dhe Toshiba dhe Lexmark nuk jepen asnje detaje se si do të kryhet ky menaxhim nga Softëare MyQ i brandit Kyocera.

4. BOE Infosoftware Office &BNT Electronics nuk ploteson pikën 2.3.8. per pajisjet A3 me Ngjyra Toshiba eStudio 3515 AC. Referuar katalogut te paraqitur, Pajisja e ofertuar nuk ploteson specifikimin:

Resolucioni Print	2400 x1200 dpi
-------------------	----------------

5. BOE Infosoftware Office &BNT Electronics Nuk plotëson pikën 2.3.8. për pajisjet A3 Bardh e zi e madhe Xerox Altalink B8145. Referuar katalogut te paraqitur, Pajisja e ofertuar nuk plotëson specifikimin: Për të konkluduar RIKON-AL shpk në vazhdim të arsyetimit të paraqitur më lart, i gjykon më se të drejta e të ligjshme pretendimet e paraqitura.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës sonë.

2. Kualifikimin e ofertës së BOE RIKON-AL & PC STORE shpk në procedurën e prokurimit nr REF-32793-12-11-2024 të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, si ofertë e suksesshme.

3. Skualifikimin e ofertës se BOE Infosoftware Office & BNT Electronics.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për

procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 395/1 Prot., datë 12.02.2025.

II.6. Në datën 18.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me 395/2 prot., Formulari i paraqitjes së argumenteve nga subjekti i interesuar BOE “InfoSoft Office” SHPK & “BNT Electronics” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 395/3 prot., datë 03.03.2025 me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE “RIKON-AL” SHPK & “PC STORE” SHPK”*, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë këtij Komisioni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së lartpërmendur.

II.8. Në datën 07.03.2025, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 395/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 9900 prot., datë 06.03.2025 me objekt: *“Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje shërbim të printimit”*, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së për sa i përket shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK. Referuar vendimit të KSHA-së rezulton se ankesa është refuzuar pasi është gjykuar e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimimit. Konkretisht është argumentuar si vijon:

“Në datën 12.12.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-32793-12-11-2024, me objekt “Blerje Shërbimi të Printimit”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh, 296,876.72 (tëo hundred ninety-six thousand eight hundred seventy-six point seventy-tëo) euro pa tvsh.

Në datën 13.01.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në datën 23.01.2025, është zhvilluar procesi i vlerësimit dhe janë njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE “RIKON-AL” sh.p.k dhe “PC STORE” sh.p.k: 28,675,000 skualifikuar.

BOE “INFOSOFT” sh.p.k dhe “BNT Electronics” sh.p.k: 28,705,000 kualifikuar.

Në datën 31.01.2025, ora 11:20, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës objekt ankimi.

Më datën 10.02.2025, në orën 19:48:00 është depozituar në formë elektronike në bazën e të dhënave të Komisionit të Prokurimit Publik, Formulari i Ankesës, nga operatori ekonomik BOE “RIKON-AL” sh.p.k dhe “PC STORE” sh.p.k me objekt “Shfuqizimi i vendimit të KVO-së mbi

skualifikimiin e ofertës të paraqitur nga BOE “RIKON-AL ” SHPK & “PC STORE” SHPK...” publikuar nga Komisioni i Prokurimit Publik “Formular për publikim Lidhur me arsyet e s'kualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar”, më datë 12.02.2025 me nr. 395/1 prot.

Në mbështetje të Nenit 112, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 101, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), u ngrit Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, sipas Urdhërit Nr. 390 datë 21.02.2025.

KSHA, pas marrjes dijeni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik dhe përllogaritjes së afateve në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, referuar nenit 110, pika 2, të ligjit Nr.162/2020 për “Prokurimit publik” (i ndryshuar), [...], konstaton se, ankesa e paraqitur nga BOE “RIKON-AL” shpk & “PC STORE” shpk është paraqitur jashtë afatit në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, në procedurën objekt ankimi.

KSHA gjykon se, referuar rrethanave të përmendura më sipër, BOE “RIKON-AL” shpk & “PC STORE” shpk ndodhet jashtë afatit ligjor për ushtrimin e të drejtës për ankimim dhe si rrjedhim, ankesa e tij nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.”

II.9. Në datën 12.03.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ripublikoi formularin e publikimit me arsyet e skualifikimit të BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK si dhe kriteret që ankimesi pretendon se nuk përmbushen nga BOE “InfoSoft Office” SHPK & “BNT Electronics” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.395 prot.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik, sa i përket formularit të ripublikuar në datën 12.03.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të BOE “Rikon-Al” SHPK & “PC Store” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës

dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të KSHA-së për refuzimin e ankesës së BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK pasi është gjykuar e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimimit, si vijon:

III.1.1. Në datën 23.01.2025, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si dhe BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij.

III.1.2. Në datën 31.01.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

III.1.3. Në datën 10.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5039, protokolluar me nr.395/2025 prot, datë 11.02.2025, i BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 395/1 Prot., datë 12.02.2025.

III.1.5. Në datën 07.03.2025, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 395/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 9900 prot., datë 06.03.2025 me objekt: “Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje shërbim të printimit”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së për sa i përket shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “RIKON-AL” SHPK & “PC STORE” SHPK. Referuar vendimit të KSHA-së rezulton se ankesa është refuzuar pasi është gjykuar e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimimit.

III.1.6. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.7. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit *mbi kufirin e lartë monetar*, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se njoftimi i fituesit është publikuar në SPE më datë 31.01.2025. KPP vëren, se në datën 10.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5039 i BOE ankimues.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë në Sistemin e Ankesave Elektronike brenda afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret, llogaritja e afatit për ankim nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit në SPE më datë 31.01.2025 dhe përfundon në ditën e 10-të. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit, ka qenë data 10.02.2025, pasi data 09.02.2025 është ditë e dielë dhe bazuar në pikën 8, të nenit 110, “Afatet

për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, [...] kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave, ndaj dhe ankesa e paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 10.02.2025, nuk konsiderohet e paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit, duke u legjitimuar *ratione temporis*.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga BOE ankimues, ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj nuk përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK se: “Operatori Ekonomik “PC Store” sh.p.k anëtar i BOE në përmbushje të kriterit 2.2.1 ka paraqitur dokumentacionin “Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit)” të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, në të cilën faktohet situata financiare vetëm për vitet 2022, 2023, por për vitin 2024 nuk faktohet situata financiare. Thënë kjo dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e kriterit 2.2.1 jo vetëm që nuk vërteton xhirot vjetore respektivisht sipas viteve financiare të kërkuara në kërkesat e kriterit të sipërcituar (2021, 2022 dhe 2023) por gjithashtu nuk është i plotë në vetvete, pasi nuk përmban situatën financiare për vitin 2024”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: **29,162,200 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.2. Nga verifikimi i kryer, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 11/01/2025, midis operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK dhe operatorit ekonomik “PC Store” SHPK.

Në Nenin 2 “Pjesëmarrja e anëtarëve të grupit” të kësaj kontrate bashkëpunimi është përcaktuar shprehimisht si vijon:

“Në këtë bashkim, shoqëritë do të jenë përgjegjëse në mënyrë solidare ndaj Autoritetit Kontraktues në lidhje me kushtet e përcaktuara në Kontratën Përfundimtare si dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin grafikut të kërkuar të lëvrimit.

Shoqëritë përcaktojnë se furnizimi i mallrave dhe shërbimeve do të jetë i specifikuar si më poshtë vijon:

PJESËMARRJA NË PËRQINDJE:

- PC STORE shpk do të ketë pjesëmarrje 20% në këtë procedurë.

- RIKON-AL shpk do të ketë pjesëmarrje 80% në këtë procedure.

Shoqeria PC STORE shpk e cila është e certifikuar sipas standardeve ISO, ISO 9001:2015, ISO 27001:2015, ISO 20001, cila merr përsipër që ne përputhje me detyrat dhe përqindjen e pjesëmarrjes respektive të përcaktuar në këtë marrëveshje, merr përsipër të realizojë, si vijon:

1. Të angazhojë 3 (tre) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha).
2. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar si project Manager ose ekuivalent për të siguruar implementimin e suksesshëm të shërbimit të kërkuar përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.
3. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
4. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Sëitching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes softëare dhe të pajisjeve të kërkuara.
5. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit softëare në infrastrukturën përkatëse dhe AD.
6. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave.
7. Të vendosë në dispozicion 3 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhënë shërbimin në kohë në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë.
8. Të furnizojë 20% të pajisjeve të printimit të kërkuara.
9. Të angazhojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të mbështetur partnerin RIKON-AL në rast se gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të kontratës.

Shoqeria RIKON-AL shpk, e cila është e certifikuar sipas sipas standardeve ISO, ISO 9001:2015, ISO 27001:2015, ISO 20001, cila merr përsipër që ne përputhje me detyrat dhe përqindjen e pjesëmarrjes respektive të përcaktuar në këtë marrëveshje, merr përsipër të realizojë, si vijon:

Të angazhojë 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik për ekzekutimin e kontrarës.

2. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
3. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
4. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
5. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar për të

implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

6. Të furnizojë 80% të pajisjeve të kërkuara.

7. Të angazhojë 4 automjete transporti për realizimin e kontratës.

8. Të angazojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të garantuar realizimin e kontratës nëse gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të saj.

Në këtë bashkim të përkohshëm të dyja shoqëritë do të marrin pjese në ndarjen e fitimit, sipas kuotave respektive të pjesëmarrje.

Kapacitetet e të dyja shoqërive të integruara në formën e Bashkimit të Përkohshëm i përgjigjen plotësisht kapaciteteve të kërkuara për pjesëmarrjen në konkurrim.

III.2.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi, se në funksion të plotësimit të kriterit 2.2.1 të mësipërm, operatori ekonomik “PC Store” SHPK, ka dorëzuar vërtetimin Nr. T12176728, datë 09.01.2025, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë, me përmbajtje si më poshtë:

“Vërtetojmë se Personi Juridik / Fizik [...] Tatimpaguesi: PC Store [...], në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:

Periudha Tatimore	Shuma
24-A	
23-A	807.396.482
22-A	785.511.707

Ky vërtetim lëshohet për pjesëmarrjen në tenderin që zhvillohet në datën 13.01.2025, sipas ftesës së bërë nga enti prokurues (institucioni): Bashkia Tiranë, me objekt prokurimi: “Blerje shërbim të printimit”, me vlerë: 29162200 lekë, me vendndodhje në Tiranë.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.5. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tri) vitet e fundit financiare.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].

Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.2.6. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Vërtetim nr. Nr. T12176728, datë 09.01.2025, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve DTM, në të cilin pasqyrohet xhiroja e vitit 2022 dhe 2023 e subjektit “PC STORE” SHPK.

Rezulton, se për vitet 2022 dhe 2023, xhiroja vjetore e shoqërisë ka qenë disa herë më e madhe se kërkesa e autoritetit kontraktor që: *“vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2021, 2022, 2023) duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: 29,162,200 lekë”*. Që të quhej i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor për xhiron, operatori ekonomik “PC Store” SHPK duhet të plotësonte kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit 2021, 2022, 2023, ndërkohë që operatori ekonomik “PC Store” SHPK e përmbush dhe e tejkalon kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7, pika 2.2.1 *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, pasi vlera e xhiros për vitet 2022 dhe 2023 është shumë herë më e madhe se 20% e fondit limit, referuar përqindjes së pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit. Pra qëllimi për të cilin autoriteti kontraktor vendos në kriteret e veçanta një kërkesë të tillë, është të vërtetojë se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të operatorit ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, të jetë jo më e vogël se fondi limit, kështu që rrjedhimisht, BOE ankimues, me dokumentacionin e paraqitur vërteton përmbushjen e këtij kriteri.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK se: *“Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik pjesë e Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumentave Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt të kësaj kontrate, duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha). Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:• Eksperienca e punës dhe profilet e inxhinierëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratë pune e vlefshme, kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional. Kriteri 2.3.3 do të konsiderohet i*

përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.”

Në zbatim të kriterit të sipërcituar, Operatorët Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k kanë deklaruar në dokumentet e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentin “Kontratë Bashkëpunimi” konkretisht:

Pc Store: 3 (tre) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha). A.A Diplomuar Informatike Ekonomike Nr.001288F A.B Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr.000191 E.M Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr.000188

Rikon-AL: Të angazhojë 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik për ekzekutimin e kontratës.

Bazuar në dokumentin “Kontratë Bashkëpunimi”, në të cilën Operatorët BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, citojnë se:

- PC STORE shpk do të ketë pjesëmarrje 20% në këtë procedurë.

- RIKON-AL shpk do të ketë pjesëmarrje 80% në këtë procedurë

Deklarimi në përmbushje të kriterit 2.3.3 nuk përkon me inxhinierët e punësuar në fushat e kërkuara pasi PC Store sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 2, ndërsa Rikon-AL sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 inxhinier. Thënë kjo Deklarimi i Rikon-AL nuk përmbush kërkesat e këtij kriteri referuar pjesëmarrjes prej 80% në këtë procedurë prokurimi.

Si rrjedhojë KVO gjykon se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, nuk përmbush kërkesat e kriterit 2.3.3 dhe nuk konsiderohet i përmbushur”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

III.3.2. Në shtojcën 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 dhe 2.3.4. të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, të publikuara në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterëve si vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt të kësaj kontrate, duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha).*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e inxhinierëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratë pune e vlefshme, kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Kriteri 2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për implementimin dhe për suportin përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me certifikata të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve të ofertuara apo nga distributori i autorizuar për pajisjet e ofertuara me kusht që të provohet e drejta legjitime e distributorit për të trajnuar dhe certifikuar stafin, për të vërtetuar aftësinë e tyre për implementim, konfigurime të komponentit softëare të kërkuar, përmbushjen e termave të SLA si dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar si project Manager ose ekuivalent për të siguruar implementimin e suksesshëm të shërbimit të kërkuar përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.
- Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- Të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar për komponentin softëare të ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Sëitching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes softëare dhe të pajisjeve të kërkuara.
- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose

ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit softëare në infrastrukturën përkatëse dhe AD.

- j. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave.

Kriteri 2.3.4 dhe nën pikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

III.3.3. Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [] Jo []
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Emri, Mbiemri _____	
Firma _____	
Vula _____	
Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër. [...].

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.3.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Kontratën e Bashkëpunimit e lidhur më datë 11/01/2025, midis tyre, ku në Nenin 2 të saj, “Pjesëmarrja e anëtarëve të grupit” është përcaktuar pjesëmarrja në përqindje si dhe përgjegjësitë e secilit, sikurse është trajtuar më hollësisht në pikën III.1.2 të arsyetimit, si më sipër cituar.

Gjithashtu rezulton, se secili prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në bashkimin e përkohshëm BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK, në përmbushje të kriterëve objekt ankimi, kanë dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 10), të plotësuar nga secili prej tyre, ku në Deklaratën për disponimin e punonjësve është deklaruar si vijon:

Operatori ekonomik “Rikon-AL” SHPK ka deklaruar:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Aktualisht – 17 punonjës Profili i punonjësve Administrator, Drejtor Shitjesh, Ekonomist, Inxhinier Elektronik, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Mekanik, Teknik elektronik, Teknik fotokopjesh, Shofer. J. S. ... - i punësuar në OE RIKON-AL, i diplomuar në Inxhinieri Elektronike nga Universiteti Politeknik i Tiranës, diploma nr ... dhe i certifikuar si vijon: <u>RICON Office Printing Engineer Certification,</u> <u>RICOH Office Printing Expert Certification</u> T. ... - i punësuar në OE RIKON-AL, i diplomuar në Inxhinieri Mekanike nga Universiteti Politeknik i Tiranës me nr diplome ... i certifikuar në: <u>RICOH Office Printing Engineer Certification,</u> <u>RICOH Printing v3 - H Servicing.</u> L. S. ... - i punësuar në OE RIKON-AL, i diplomuar në Inxhinieri ... nr diplome ... dhe i certifikuar në <u>RICOH Printing v3 - HW Servicing.</u> <u>RICOH Streamline NX v3.5.x - Software Services</u> B. ... - i punësuar në OE RIKON-AL dhe i certifikuar në: <u>RICOH Network Management (Tech)</u> <u>RICOH Streamline NX v3.5.x - Software Services</u> A. ... - i punësuar në OE RIKON-AL dhe i certifikuar në: <u>RICOH Digital Imaging V2 - HW Servicing</u> A. ... - e punësuar në OE RIKON-AL dhe e certifikuar në: <u>RICOH Digital Imaging V2 - HW Servicing</u> B. ... - i punësuar në OE RIKON-AL dhe i certifikuar në: <u>RICOH Network Management (Tech)</u> <u>RICOH Streamline NX v3.5.x - Software Services</u> E. ... - i punësuar në OE RIKON-AL dhe i certifikuar në: <u>RICOH Digital Imaging V2 - HW Servicing</u> G. ... - i punësuar në OE RIKON-AL dhe i certifikuar në: <u>RICOH Digital Imaging V2 - HW Servicing</u> G. ... - i punësuar në OE RIKON-AL dhe i certifikuar në: <u>RICOH Digital Imaging V2 - HW Servicing</u>
	O. ... - i punësuar në OE RIKON-AL dhe i certifikuar në: <u>RICOH Digital Imaging V3 - HW Servicing</u>

Operatori ekonomik "PC Store" SHPK ka deklaruar:
B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 68 punonjës Profili i punonjësve: Administrator, Inxhinier elektronik, Teknik elektronik, etj. stafin e inxhinierëve të profileve si më poshtë: 1. 3 (tre) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha). A. ... Diplomuar Informatike Ekonomike Nr. ... A. ... Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr. ... E. ... Diplomuar Inxhinieri Elektronike Nr. ... Stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për implementimin dhe për suportin përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.

do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor	1 (një) specialist të certifikuar si project Manager ose ekuivalent për të siguruar implementimin e suksesshem të shërbimit të kërkuar përgjatë kohëzgjatjes së kontratës. R. ... Shkencor diplomuar në programin Master Shkencor, Sistemet e Informacionit në Biznes nga UMSH diploma nr. ... International Business Management Institute Projekt Management ID: 325... Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit. L. ... Zebra Certifikate Mobile Solutions Qverview R. ... Zebra Certifikate ET60W/ET65W Rugged Windows Tablets Product Overview 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Switching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes software dhe të pajisjeve të kërkuara. L. ... CCNP Cisco Network Profesional Enterprise id:XMC2D0DL8LB411SY 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit software në infrastrukturën përkatëse dhe AD. L. ... -Microsoft Certified System Engineer: Windows Server Nr. ... L. ... -Microsoft Certified IT Profesional: Windows Server Nr. ... 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave. L. ... -Microsoft Certified System Engineer: Windows Server Nr. ... L. ... -Microsoft Certified IT Profesional: Windows Server Nr. ...
--	---

III.3.5. Në ankesën e paraqitur në sistemin elektronik të ankesave të KPP-së, pretendohet shprehimisht se: “*Theksojmë se kjo arsye skualifikimi i paraqitur nga KVO në AK, është një arsye skualifikimi e pambështetur në ligj dhe për më tepër as në logjikën e thjeshtë të procedurave të prokurimit publik.*

OE RIKON-AL, duke qenë se nuk dispononte në listëpagesë të gjithë inxhinierët dhe makineritë/pajisjet e kërkuar nga AK, gjykoi të bashkonte kapacitetin teknik me OE PC STORE, për të ofertuar si bashkim operatorësh ekonomike në procedurën e tenderit objekt ankimi.

Duke qenë se LPP, detyron qe BOE të krijohet si e tillë përmes hartimit të një kontratë ndërmjet palëve pjesëmarrëse, BOE RIKON-AL dhe PC STORE, kanë nënshkruar dhe paraqitur në SPE, kontratën e bashkëpunimit të datës 11.01.2025, ku janë përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes dhe të drejtat dhe detyrimet konkrete të palëve kontraktuese.

Konkretisht PC STORE, me pjesëmarrje 20% në BOE, merr përsipër si vijon:

Shoqeria PC STORE shpk e cila është e certifikuar sipas sipas standardeve ISO, ISO 9001:2015, ISO 270001:2,I,SO 200001, cila merr përsipër që ne perputhje me detyrat dhe perqindjen e pjesëmarrjes respektive te percaktuar ne kete marreveshje, merr përsipër të realizojë, si vijon:

- 1. Të angazhojë 3 (tre) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha).*
- 2. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar si project Manager ose ekuivalent për të siguruar implementimin e suksesshem të shërbimit të kërkuar pergjate kohezgjatjes së kontratës.*
- 3. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.*
- 4. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Sëitching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes softëare dhe të pajisjeve të kërkuara*
- 5. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit softëare në infrastrukturën përkatëse dhe AD.*
- 6. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE per Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave.*
- 7. Të vendosë në dispozicion 3 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhënë shërbimin në kohë në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë.*
- 8. Të furnizojë 20% të pajisjeve të printimit të kërkuara.*
- 9. Të angazojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të mbështetur partnerin RIKON-AL në rast se gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të kontratës.*

Dhe lider i BOE, OE RIKON-AL, merr përsipër si vijon:

Shoqeria RIKON-AL shpk, e cila është e certifikuar sipas sipas standardeve ISO, ISO 9001:2015, ISO 270001: ISO 200001, cila merr përsipër që në përputhje me detyrat dhe perqindjen e pjesëmarrjes respektive të përcaktuar në këtë marrëveshje, merr përsipër të realizojë, si vijon:

- 1. Të angazhojë 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik për ekzekutimin e kontratës.*

2. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
 3. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
 4. Të angazhojë 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
 5. Të angazhojë 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
 6. Të furnizojë 80% të pajisjeve të kërkuara.
 7. Të angazhojë 4 automjete transporti për realizimin e kontratës.
 8. Të angazojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të garantuar realizimin e kontratës nëse gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të saj.
- Pra, kjo kontratë BOE është një bashkim i mirëfilltë për përmbushjen së bashku të kontratës për sa i përket kapacitetit teknik. Kapaciteti Teknik, si rregull përmban:

1. Burimet njerëzore të kualifikuara
2. Automjete dhe kapacitete logjistike
3. Makineri dhe pajisje

Dhe për të përmbushur kapacitetin teknik, është përcaktuar që në total, RIKON-AL të përmbushë 80% të volumit të kontratës, përfshirë vendosjen e pajisjeve të printimit/fotokopjimit/skanimit në masën 80% të tyre, (nr i këtyrë pajisjeve është pjesa më e rëndësishme e zbatimit të kontratës publike), angazhimin e inxhinierëve/specialistëve/teknikëve të kualifikuar dhe automjeteve për transportin e pajisjeve në adresat e përcaktuara nga AK.

Gjithashtu edhe PC STORE, merr përsipër të vendosë 20% të totalit të pajisjeve të printimit/fotokopjimit/skanimit, si edhe angazhimin e inxhinierëve/specialistëve/teknikëve të kualifikuar dhe automjeteve për transportin e pajisjeve në adresat e përcaktuara nga AK.

Ndarja 80% për RIKON-AL dhe 20% për PC STORE, është një marrëdhënie mes dy palëve konkrete dhe nuk është shqetësimi i KVO, pretendimi i pabazuar se PC STORE ka vënë 1 inxhinier më pak dhe RIKON 1 inxhinier më shumë apo sesa punonjës duhet të punësojë në cilësinë e inxhinierit RIKON-AL dhe PC STORE.

Për më tepër, PC STORE në çdo rast, sipas dispozitave të kontratës së bashkëpunimit merr përsipër të angazhojë burime dhe asete shtesë, për të ndihmuar partnerin RIKON-AL për zbatimin e kënaqshëm të kontratës nëse një sfidë e tillë shtrohet për zgjidhjen nga AK, apo rrethanat e realizimit të kontratës.

Duke qenë se vendosja e pajisjeve në punë në ambientet e AK, përbën sfidën më të madhe kontraktuale në kontratën publike, ndarja 80%/20% mes antarëve të BOE i përgjigjet më së miri detyrimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit të paraqitur në SPE.

Nuk është as e drejtë e as detyrë e KVO në AK, të vlerësojë së si duhet të jenë marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet antarëve të një BOE ofertues në procedurën e prokurimit.

Detyra që shtrihet ligji për prokurimin publik për zbatim për KVO është vlerësimi dhe garantimi se OFERTUESI disponon mjetet e duhura financiare, eksperiencën e duhur, burimet njerëzore të

kualifikuara dhe kapacitetet logjistike dhe operacionale për të marrë përsipër realizimin e kësaj kontrate publike dhe asgjë më shumë se përtej kësaj detyre. Çdo tejkalim përbën një akt administrativ të nxjerrë në mungesë të kompetencës.

Prandaj për sa më sipër, vendimi i KVO për skualifikimin e BOE me pretendimin që “Deklarimi në përmbushje të kriterit 2.3.3 nuk përkon me inxhinierët e punësuar në fushat e kërkuara pasi PC Store sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 2, ndërsa Rikon-AL sh.p.p duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 inxhinier. Thënë kjo Deklarimi i Rikon-Al nuk përmbush kërkesat e këtij kriteri referuar pjesëmarrjes prej 80% në këtë procedurë prokurimi.” është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet të hidhet poshtë.

III.3.6. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.8. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.3.9. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.11. Në nenin 88 pika 1,2 dhe 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi.

Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

III.3.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.3.13. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Referuar arsytimit të autoritetit kontraktor rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues "Rikon-AL" SHPK & "PC Store" SHPK, është skualifikuar për mospërmbushje të kërkesës për staf inxhinierik nga anëtari i bashkimi të operatorëve "Rikon-AL" SHPK, pasi *Rikon-AL sh.p.k duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 inxhinier. Deklarimi i Rikon-Al nuk përmbush kërkesat e këtij kriteri referuar pjesëmarrjes prej 80% në këtë procedurë prokurimi*, sipas pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT. Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 83, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Referuar dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 ka përcaktuar se: *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt të kësaj kontrate, duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) inxhinierë të profileve, të tilla si, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha). Kriteri 2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.* Ndërsa sipas specifikimeve teknike të DT-ve, Komisioni konstaton se, objekti i prokurimit ka për qëllim të realizojë furnizimin (vënia në dispozicion) me pajisje të reja sipas kërkesave të AK-së; instalimin dhe realizimin e konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimin (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit; shërbimin e mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimin e defekteve në çdo kohë, zëvendësimin e pjesëve konsumuese vetëm origjinale (toner/bojëra origjinal, drum origjinal, rulatë ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve) përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit, garantimin e furnizimit të pandërprerë me toner/bojëra origjinal dhe pjesëve të tjera të konsumueshme origjinale të të gjitha pajisjeve që do të përdoren, (sipas SLA të parashikuar) si dhe sigurimin e një server për të qendëruar përpunimin dhe ruajtjen e dokumenteve dhe softëare të centralizuar për menaxhimin dhe monitorimin e shërbimit dhe realizimin e instalimit dhe konfigurimit të tyre në infrastrukturën ekzistuese në institucion. Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekt i këtij shërbimi janë: Bashkia Tiranë në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin e saj administrativ, 24 Njësitë Administrative dhe 3 Lagjet e reja si dhe çdo vendndodhje e re e cila mundet të dalë gjatë kohëzgjatjes së shërbimit sipas kushteve të përcaktuara në këtë dokument.

Në përmbushje të objektit të prokurimit, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK, ka dorëzuar: Kontratë bashkëpunimi datë 11.01.2025, ndërmjet shoqërisë “Rikon-AL” SHPK & shoqërisë “PC Store” SHPK, ku secila do të kontribuojë përkatësisht në masën 80% me 20% në këtë pjesëmarrje. Sipas kësaj kontrate bashkëpunimi shoqëritë do të jenë përgjegjëse në mënyrë solidare ndaj Autoritetit Kontraktor dhe shoqëria PC Store shpk ka marrë përsipër të angazhojë 3 (tre) inxhinierë të profileve, informatikë, elektrikë, elektronikë, teknologji informacioni ose mekatronik (apo të ngjashme me këto fusha; 1 (një) specialist të certifikuar si projekt Manager ose ekuivalent për të siguruar implementimin e suksesshëm të shërbimit të kërkuar përgjatë kohëzgjatjes së kontratës 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit; 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Sëitching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e të gjithë zgjidhjes softëare dhe të pajisjeve të kërkuara; 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Windows Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit softëare në infrastrukturën përkatëse dhe AD; 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të

gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave si dhe ka marrë përsipër të vendosë në dispozicion 3 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhënë shërbimin në kohë në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë; të furnizojë 20% të pajisjeve të printimit të kërkuara; të angazhojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të mbështetur partnerin RIKON-AL në rast se gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të kontratës. Ndërsa shoqëria Rikon-AL shpk, ka marrë përsipër që, në përputhje me detyrat dhe përqindjen e pjesëmarrjes respektive, të përcaktuar në këtë marrëveshje, të angazhojë 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik për ekzekutimin e kontratës, 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit; 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Bardh e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit; 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 me ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit; 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje A4 printer të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit si dhe ka marrë përsipër gjithashtu të furnizojë 80% të pajisjeve të kërkuara; të angazhojë 4 automjete transporti për realizimin e kontratës; të angazhojë asete, burime njerëzore dhe pajisje shtesë, për të garantuar realizimin e kontratës nëse gjykohet e nevojshme gjatë ekzekutimit të saj.

Gjithashtu për përmbushjen e kriterit në fjalë, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën e III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, operatori ekonomik “Rikon-AL” SHPK ka deklaruar se disponon 3 inxhinierë, përkatësisht elektronik, mekanik dhe mekatronik, në përputhje me angazhimin e marrë përsipër në Kontratën e bashkëpunimit datë 11.01.2025, ndërmjet shoqërisë “Rikon-AL” SHPK & shoqërisë “PC Store” SHPK. I njëjti deklarin i bërë nga shoqëria “PC Store” SHPK në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit përputhet me angazhimin e marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit datë 11.01.2025 si më lart sipërcituar.

Sa më sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e KVO-së nuk është bërë asnjë analizë e thelluar lidhur me elementët konkretë të marrë përsipër nga secili anëtar i BOE sipas kontratës së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre përsa i takon përqindjes së pjesëmarrjes në këtë bashkëpunimin nga secili anëtar, dhe në raport, me të cilat duhet të përmbushen kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit lidhur me treguesit ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, të cilat duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, sikurse specifikohet në nenin 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, për të përcaktuar veçanërisht treguesin teknik sa i takon stafit inxhinierik të secilit prej tyre. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e

kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”* ka për detyrë të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

Në kushtet kur BOE ankimues ka dhënë indicie për autoritetin kontraktor, ky i fundit, në përputhje me nenin 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”* ka pasur detyrimin procedural të kryejë verifikimet përkatëse, apo të kërkojë sqarime nga ankimuesi, gje për të cilin rezultoi, se AK nuk i ka kryer këto verifikime, duke e marrë të mirëqenë që BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK nuk plotëson kapacitetin teknik lidhur me numrin e inxhinierëve.

Sa më sipër, pretendimet e BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK qëndrojnë pjesërisht.

III.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK se: *“III. Autoriteti Kontraktor në kriterin 2.3.7 pjesë e kapacitetit teknik kërkon: “2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.”* BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k në përmbushje të kriterit 2.3.7 ka paraqitur dokumentacionin “Deklaratë” të datës 13.01.2025, në të cilën deklaroi se: *“Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Në rast se renditemi si oferta më e mirë, në zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me*

dokumentacionin e ofertës do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të paisjeve.” Si dhe në pikën B: “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të dokumentit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit shtojca 10 e dokumenteve standarte të tenderit Operatori Ekonomik ka deklaruar “Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Në rast se renditemi si oferta më e mirë, në zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me dokumentacionin e ofertes do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të paisjeve.” Referuar sa më sipër KVO gjykon se bazuar në kërkesat e kriterit 2.3.7 Autoriteti Kontraktor thekson qartësisht se “Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të paisjeve, dhe nuk citohen se plotësimi i këtij kriteri përmbushet/vërtetohet nëpërmjet një deklarate të nënshkruar nga Operatori Ekonomik. Gjithashtu theksojmë se ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur në këtë moment procedural, me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B të DST, sikurse nuk është kërkuar në kërkesat e këtij kriteri. Si rrjedhojë KVO gjykon se Operatori Ekonomik BOE “Rikon-AL” sh.p.k dhe “PC Store” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion vërtetues sipas kërkesave të kriterit 2.3.7 dhe nuk konsiderohet i përmbushur.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.7 e dokumentave të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të paisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.

III.4.2. Në Procesverbalin e argumentimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, njësia e prokurimit ka argumentuar si vijon:

Argumentimi:

Bazuar në nenin 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

AK, në një projekt ku është parashikuar të realizohet një shërbim i domosdoshëm dhe i vijueshëm për çdo ditë punë, ku kërkohet vendosja në dispozicion e 228 pajisjeve dhe për me tepër e shpërndarë në 47 vendndodhje të ndryshme të shpërndara gjeografikisht në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë (përcaktuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike), e vlerëson të nevojshëm dhe bazike kërkesën për të patur stok 45 % të pajisjeve.

AK ka përcaktuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, afatin e ekzekutimit, konkretisht dy muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Gjatë këtij afati, përfshihet jo vetëm lëvrimi i një sasive voluminoze pajisjesh në të gjithë vendndodhjet e përcaktuara për ofrimin e shërbimit (47 vendndodhje të ndryshme), por edhe instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit dhe në komponentin softëare që do të lëvrohet nëpërmjet kësaj kontrate, në mënyrë që shërbimi të jetë aktiv brenda afatit dy mujor të parashikuar. Nëse OE nuk ka kapacitetet e duhura gjendje në magazinë, nisur nga volumi dhe domosdoshmëria e marrjes së shërbimit objekt i kësaj kontrate, rrezikohet përmbushja e detyrimeve të saj.

Si rrjedhojë, kërkesa mbi gjendjen në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara i jep garanci autoritetit kontraktor se OE disponon kapacitetet e nevojshme teknike (pajisje e asete të tjera fizike) për të siguruar implementimin e infrastrukturës së nevojshme, në funksion të ofrimit të shërbimit brenda afatit 2 (dy) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

III.4.3. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoi këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër. [...].

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë

dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.4.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër cituar, ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratë datë 13.01.2025, nëpërmjet të cilës deklarohet se *Deklaratë e bashkimit të operatoreve ekonomike pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë 13.01.2025 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës me objekt prokurimi “Blerje Shërbim të Printimit” me fond limit 29,162,200(njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind). Unë i nënshkruari Agon Makolli, me cilësinë e Administratorit të personit juridik RIKON-AL shpk deklaroj se: 1. Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Ne rast se renditemi si oferta me e mire, ne zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me dokumentacionin e ofertes do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Data e dorëzimit të deklaratës 13.01.2025 BOE RIKON-AL & PC STORE*

2. Formular përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 10), të plotësuar nga shoqëria “Rikon-AL” SHPK, ku në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), “Pajisje printimi/fotokopjimi/skanimi” është deklaruar nga BOE RIKON-AL & PC STORE se: *“Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Ne rast se renditemi si oferta me e mire, ne zbatim të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashkë me dokumentacionin e ofertes do të paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve.”*

III.4.5. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.4.7. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.4.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda

operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.4.9. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[....]”

III.4.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimit të tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban

informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për disponimin gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara si më sipër cituar, BOE ankimes ka paraqitur në ofertë një deklaratë me datë 13.01.2025, nëpërmjet të cilës deklarohet shprehimisht: “1. Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Ne rast se renditemi si oferta me e mire, ne zbatim te nenit 26 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashke me dokumentacionin e ofertes do te paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të paisjeve. Data e dorëzimit të deklaratës 13.01.2025 BOE RIKON-AL & PC STORE” si dhe është paraqitur Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit (shtojca 10), të plotësuar nga shoqëria “Rikon-Al” SHPK, ku në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), “Pajisje printimi/fotokopjimi/skanimi” është deklaruar nga BOE RIKON-AL & PC STORE se: “Deklarojmë se disponojmë gjendje në magazinë (në stok) 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Në rast se renditemi si oferta më e mirë, në zbatim të nenit 26 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 (i ndryshuar) “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, bashke me dokumentacionin e ofertes do te paraqesim faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të paisjeve.”

Sipas shtojcës 10, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklaratash do të bëhen në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund t’i marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike.** Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilin ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t’i referohet

Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesës për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike.** Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata, dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për sa i përket BOE “InfoSoft Office” SHPK & “BNT Electronics” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi të cilët kanë ofertuar me një vlerë më të lartë ekonomike, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim nga ky Komision.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr.REF-32793-12-11-2024, me objekt: “*Blerje Shërbim të Printimit*”, me fond limit 29,162,200 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 13.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Rikon-AL” SHPK & “PC Store” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

